



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË SHA

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ . 2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje material hidraulike”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44115210-4
materiale hidraulike**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,833,333 (dy milion e teteqinde e tridhjetë e tre mijë e treqinde e tridhjetë e tre leke) **pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ujesjelles Kanalizime Himarë sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e përlllogaritur/fondi limit i kontratës.

❖ *Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

❖ *Shënim: Bilancet vjetore duhet të shoqërohen me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenin 13 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin" dhe nenin 41 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- | | |
|--|-----------|
| a) | Për |
| kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm: | |
| - | Vërtëtim |
| të lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, sipas formularit të vlerësimit për realizimin e punimeve referuar shtojcës Nr. 9 të DST –ve, | |
| - | Situacion |
| përfundimtar | |
| b) | Në rastin |
| e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm: | |
| - | Fatura |
| tatimore | |
| - | Situacio |
| ni përfundimtar | |
| - | Akt |
| kolaudimi | |

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë aftësinë dhe kapacitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,

duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.“

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesin **dëshmi** për përvoja të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më pak se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar nga një Ent publik, OE duhet të paraqesin: Vërtetimin e lëshuar nga Enti publik për permbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose, Fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Paraqitja e njërit prej dokumentave të sipërcituara do të konsiderohet i mjaftueshëm.
- b) Kur furnizimet e mëparshme, të ngjashme, janë realizuar me sektorin privat, OE duhet të paraqesin si dëshmi vetëm Fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

II-Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë, ose e përditësuar ku të jete pasqyruar objekti i prokurimit. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë persiper sipas akt-marreveshjes.) Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse (të përkthyer dhe të noterizuar).

Baza ligjore (VKM nr.285,datë 19,05,2021 neni 44,pika 1” Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë

akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Argumentimi: Ky kriter vendost për arsye se OE që vepron në fushën e objektit të prokurimit nëpërmjet kësaj certifikate duhet të jetë garantues sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë afirmim se produktet që do të dërgohen plotësojnë ose tejkalojnë standardet e përcaktuara EN12201-1, EN12201-2, EN12201-3 ose ekuivalent. Ky afirmim do të jetë në formën e një dokumenti me shkrim nga prodhuesi i cili dëshmon se procesi i prodhimit përmbush standardet.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një autorizim midis prodhuesit dhe O.E për sigurinë e cilësisë së materialeve. Dokumenti me shkrim duhet të jetë në gjuhën Shqipe (ose i përkthyer në gjuhën Shqipe) dhe i noterizuar. (-Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vertetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar)

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë rezultate të ndryshme të testimeve që janë bërë sipas standardeve: Testimi hidrostatik laboratorik në përputhje me manualin e praktikave M55 dhe manualin PPI për tubacionet poliethilene (PE) ujësjellesi.

Ose, Testimi hidrostatik laboratorik në përputhje me EN 12201-2, EN ISO 1183-1, EN ISO 1183-2, EN 728, (një prej këtyre standardeve ose ekuivalent). Në rezultatet e këtyre testimeve dhe analizave të tubacioneve HDPE dhe rakorderive Operatori ekonomik duhet të sigurojë se mallrat e prodhuesit:

-
- Përmbushjen e kërkesave minimale të presionit sipas standardeve të parashtruara.
 - Rezistencën e tubacioneve dhe paisjeve ndaj korezionit

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat e mëposhtme të prodhuesit: EN12201 – 1,2,3 ose ekuivalent.

2.3.5 Deklarate notoriale me shkrim të firmosur nga Ofertuesi në të cilën deklaron me përgjegjësi të plote se është në gjendje teknike të përmbushë specifikimet teknike të tenderit dhe do të plotësojë kohën e levrimit të mallit.

2.3.6 Nëse operatori ekonomik furnizohet nga një operator tjetër (prodhues), do të paraqesë autorizim ose kontratë të furnizimit me shkrim, të konfirmuar nga prodhuesi. Ky dokument duhet të vertetojë se O.E është distributor zyrtar i prodhuesit.

Argumentim :ky kriter vendost pasi provon vijueshmërinë dhe besueshmërinë e OE në fushën e prokurimit,pasi ky OE rezulton të jetë klient i vazhdueshëm për mallrat objekt prokurimit. Kriteri i vlerësimit nga AK është oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim. Kjo nuk pengon asnjë OE të paraqesë të dhëna për mallrat objekt prokurimi që nuk janë prodhuar në vendet e BE apo SHBA, por që plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara dhe ofrojnë cilësi. **Nga ana e AK është përcaktuar fjala “preferohet” çka nuk tregon detyrim për vendin e origjinës së mallit.**Për këtë arsye AK nuk ka përcaktuar detyrimisht se është e detyrueshme që fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës” ose “fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës” sepse do të ndodheshim në kushtet e parashikuara nga nenin 3/2 të Ligjit 162/2020 kur është përcaktuar vendi i prodhimit të mallit , duke cënuar konkurrencën. Sikundër u sqarua më lart ky paragraf nuk ndikon në vlerësimin e ofertave dhe as në origjinën e mallit që do të ofrohet nga çdo OE për sa kohë ky mall (pavarësisht ku është prodhuar) plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe garanton cilësi të lartë.

Baza ligjore (VKM nr.285,datë 19,05,2021 neni 40,pika 6,gërma b dhe c” Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.c) fotografitë apo katalogët teknikë”

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat e mëposhtme:

a.**EN ISO 9001** të vleshme “Per Sistemin e menaxhimit te Cilesise ”, ose ekuivalente per fushen e aktivitetit import-eksport dhe tregeti me shumice dhe pakice te materialeve hidraulike,hidrosanitare etj...

b.**EN-ISO 14001** të vleshme “Per Sistemin e menaxhimit te mjedisit”, ose ekuivalente per fushen e aktivitetit import-eksport dhe tregeti me shumice dhe pakice te materialeve hidraulike,hidrosanitare etj...

c.**BS OHSAS 18001** të vleshme “Per Sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune”, ose ekuivalente per fushen e aktivitetit import-eksport dhe tregeti me shumice dhe pakice te materialeve hidraulike,hidrosanitare etj...

-Deklarata OE e konformitetit për materialet, shoqëruar me Certifikata (EA) ose ekuivalent.

Argumentim:Në lidhje me kërkesën për certifikatën ISO 9001-2015 dhe 14001 të prodhuesit në momentin e dorëzimit të mallit sqarojmë paraprakisht se ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij. Në kushtet kur malli objekt prokurimi është i një rëndësie të veçantë pasi do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë detyrimisht që për arsyet e lartpërmendura për certifikatën ISO 9001 kërkohet që ky dokument të zotërohet dhe nga prodhuesi i mallit. Duke qenë të qartë (duke studiuar dhe tregun vendas) që në Shqipëri nuk ka prodhues të pompave të ujit dhe elektromotorëve dhe ky mall vjen nga importi,pavarësisht se kjo kërkesë nëpërmjet OE fitues i drejtohet një pale tjetër (prodhuesit) jo vetëm që garanton cilësinë e mallit të prodhuar, por dhe për arsye të tjera që nuk varen nga AK ose OE fitohet kohë duke u shmangur verifikimi i të dhënave të prodhuesit nga AK. Gjithashtu kërkimi i certifikatave të cilësisë siç u përmend ka të bëjë me mallin objekt prokurimi, rëndësinë e tij duke qenë i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe të provohet fakti që janë të përshtatshme për kontaktin me ujin e pijshëm .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Fabjola Çaushaj

Klejdi Veshaj

Maria Veizaj